



DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJE
DIREKTORATE OF EDUCATION

Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

DATA/DATUM/DATE	06.12.2021
NR/BR.	07/nr. <u>1380</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021/2022
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs: Për ndarjen e bursave për studentët, për vitin akademik 2021/2022.

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenin 10, të Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë, për vitin akademik 2021/2022 Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

Për dhënien e 100 bursave fillestare për vitin akademik 2021/2022.
Përparësi për fitimin e bursës kanë studentët e degëve deficitare.

Kushtet: Të drejtë për të aplikuar kanë studentët të cilët:

- Të jenë banorë rezidentë të Komunës së Ferizajt,
- Të jenë student që studiojnë në universitete të Republikës së Kosovës, por jo ata me vetëfinancim, korrespondencë, studentë në studime pasuniversitare Master dhe Doktoratë,
- Të jenë studentë së paku në vitin e dytë të studimeve themelore- Bachelor,
- Të jenë studentë të rregullt,
- Të kenë të kryera të gjitha provimet e vitit paraprak,
- Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa.
- Të kenë notën mesatare 7.50 e më të lartë,
- Të jenë studentë të cilët nuk kanë humbur dhe nuk janë përsëritës të vitit.

Kriteret për përzgjedhje:

Fëmijëve të dëshmorëve të UÇK-së iu ndahet bursa pa kriterë.

Në kushte të barabarta përparësi kanë studentët e familjeve të ngushta të dëshmorëve, invalidëve, pjesëmarrësve të luftës dhe ata me gjendje të vështirë ekonomike-sociale.

Bursa ndahet për dhjetë muaj, nga 50 euro në muaj, gjithsej 500 euro.

Studenti nuk ka të drejtë të marr dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore, apo burime të ndryshme.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kërkesa për aplikim,
- Çertifikata e provimeve të dhëna (**originali**), me kopjen e indeksit nëse keni indeks,
- Vërtetimi për dhënien e të gjitha provimeve të vitit paraprak,
- Vërtetimi për regjistrimin e semestrit përkatës vitit të studimeve 2021/2022,

- Dëshmi se është banor i Komunës së Ferizajt,
 - Deklarata e anëtarëve të familjes,
 - Letërnjoftimin personal, kopje,
 - Llogarinë personale të bankës, kopje,
 - Vërtetimi nga Administrata Tatimore që nuk janë në marrëdhënie pune;
 - Vërtetimin se është fëmijë i dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, i martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara, pa prind dhe që është në skemë sociale.
 - Diplomë, mirënjohje, çertifikatë për suksese të arritura në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit.
 - Nëse vërtetohet se studenti që është përfitues i bursës nga komuna, është duke marrë bursë nga ndonjë njëri tjetër buxhetore, ai/ajo obligohet të kthejë bursën.
- Me rastin e aplikimit studentët me vete duhet të sjellin indeksin apo çertifikatën për verifikimin e notave.

Kërkesa për aplikim merret në zyrën për shërbimin e qytetarëve për drejtorinë e Arsimit në Komunë,

Dokumentet e pa kompletuara nuk pranohen, dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë**, nga dita e publikimit në tabelën shpalljeve, web faqen e Komunës, respektivisht prej datës: 06.12.2021 deri më 20.12.2021.